

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

YZEDIN HIMA

MITI I FEMRËS NË LETËRSINË E PENGUAR

Në “Letërsinë e penguar”, për shkak të rrethanave në të cilat kjo letërsi u nyjëtua, figura e femrës është vërtetë një mit. Për shumë të burgosur femra ka qenë ylli polar që i udhëhoqi drejt lirisë përmes vuajtjeve mbinjerëzore të burgut. Femra, ose dashuria për të, ishte për të dënuarit i vetmi qëllim për të cilin ia vlente të mbijetoje në atë ferr, ku ajo që vlente më pak se hiçi që jeta. Përballë brutalitetit, dhunës, shëmtisë, pisit, ushqimit të pështirë, mjedisit të ashpër mashkullor të burgut, figura e femrës që si imazhi i oazit për njeriun që vrapon mes shkretëtirës. Urrejtja në burg që me tepri, kurse dashuria mungonte. Vizatimi i një nudoje në një pllakë guri në mjediset e burgut të Spaçit u përjetua nga diktatura dhe krijoi një shtjellë më keq se shkrimi i një parulle kundër saj. Linjat e saj të buta, arti i vizatimit, ishte në kundërshtim me parullat, altoparlantit, britmat e kapterëve, dhunën e tyre mbi të burgosurit. Ajo nudo femre që e kundërta e gjithçkaje që përjetonte i burgosuri në atë mjedis. Diktatura kujdesej pikërisht për të goditur aty ku dhembte më shumë, te dashuria, duke detyruar gratë apo të fejuarat e të dënuarve politikë që të divorcoheshin me ta. Duke ua këputur këtë lidhje me botën tej telave me gjemba, dënimi dhe vuajtja merrnin përmasat që diktatura dëshironte dhe izolimi nga bota bëhej i plotë. Pas divorceve, i dënuari nuk largohej nga burgu as me mëndje, se s’kishte se ku të shkonte. Në librat me kujtime nga burgu janë të shumtë shembujt kur të burgosurve u njoftohej divorci me femrat e tyre, sikurse pati shumë e shumë raste kur femrat e të burgosurve u shndërruan në torsa dhembjeje në pritje të burrave të tyre, që dënoheshin dhe ridënoheshin nga diktatura më diabolike në botë. Diktatura që e vetëdijshme që t’i drejtonte ndëshkimet e saj jo vetëm te trupi, por më shumë te shpirti, sikurse nënvizon Mishel Foucault.

Miti i femrës në tekstet poetikë të Visar Zhitit është po kaq i pranishëm sa miti i poezisë. Femra dhe poezia në tekstet e tij shpesh shndërrohen në njëra - tjetrën. Krijimi i poezisë i ngjet zhveshjes së femrës, ku zbulohet forma magjepsë jo vetëm e saj, por edhe e poezisë: *E si të mos të të vijë keq / për ato duar që të zhvishnin / nga kotësia e rrobave prej mjegulle / duke të bërë lumë pa brigje / ndërsa gishtat e dridhjes / pikonin yje, yje blu, ar dhe bardhësi yjesh...*

Një krijues si Visar Zhiti, në gjendje permanente mahnje, arrin të estetizojë edhe burgun, këtë ferr, jo më femrën që në analizë të fundit, nga pikëpamja e formës është vërtetë një vepër arti. Në tekstin e poezisë “Duart e keqardhjes”, poezi e shkruar në burg, Visar Zhiti vizaton format artistike të femrës që duart e tij njëkohësisht e zhveshin dhe e krijojnë: ... *e shtrirë, lakuriqe, / relief hyjnor, e*

*butë dhe rënkongjëse / vazhdimisht braktisëse formash / bëheshe hapësirë e hutuar, / zjarr brenda akullit, borë që bie në ëndërr...*¹

Dhe pas gjithë kësaj dehjeje estetike teksti sjell një pamje krejt tjetër. Duart që aq bukur zhvishnin, zbulonin, modelonin e krijonin, mbërthehen padrejtësisht në pranga, pikërisht pse krijuan: *Dhe kumbonin duart e frymëzuara / mbi trupin tënd / si një piano. / Ato duar që i arrestuan / dhe u vunë pranga të rënda sa e shkuara pa ty./... Ah, ikën duart e mia, vetëm / Vijnë tek ty si dy lejlekë të trembur.*²

Në tekstet poetikë të Visar Zhitit femra mitizohet jo thjesht për hiret e saj, por edhe për virtytet. Gratë e të burgosurve politikë, sikurse shkruam edhe më lart, në më të shumtën e rasteve kanë ditur të mposhtin diktaturën pikërisht me virtytet e tyre, “material” shpirtëror i paasgjësueshëm nga asnjë lloj dhune. Në një tekst poetik pa titull të Visar Zhitit, gruaja e të burgosurit shihet si një pemë që qëndron buzë humnerës. Gjethet e saj janë të heshtura, nuk mund të fëshfërijnë. Nga pikëllimi këto gjethe bien e bien. Vjeshta është stina e tyre e përhershme, si stinë e ndarjes, e pikëllimit. Gruaja është pemë e brishtë, e rrezikuar: *Gruaja e të burgosurit / është pemë / buzë humnerash / gjethe të heshtura / nga pikëllimi i saj / bien dhe mbushin / botën.*³

Uni poetik trishtohet shumë nga shpërdorimi që i bëhet së bukurës, trajtimi jonjerëzor i femrës, fyerja e dinjitetit të saj, mungesa e respektit për të. Në tekstin e poezisë “Në kullën e gruas së bukur” poeti Visar Zhiti vizaton me dhembje portretin e saj të poshtëruar nga statusi i saj i ulët në familje. Poezia është shkruar në vitin 1979 në fshatin Vilë të Kukësit, ku autori punonte si mësues. Është një himn, por edhe trishtim për femrën, për të bukurën e traumatizuar: *...Në odën e madhe, shtrirë mbi qilimat e tu, /dëgjoj i ngrysur / hapat e tua prej ballade. / S’e di nga e kuptova, ti je dëshpërimisht e bukur, / nga qëndismat mbase. / Futesh vetëm për të na larë këmbët, / fytyra jote çdo mbrëmje mbytet nëpër legenët. / Trarët e kullës ndjejnë dhembje / si atëherë, kur i ndanë nga pemët.*⁴

Propaganda për emancipimin e gruas në diktaturë ishte qesharake. Pa u emancipuar e gjithë shoqëria, nuk mund të ketë emancipim të femrës. Në diktatura as që mund të bëhet fjalë për shoqëri të emancipuar, ku mungon kriteri numër një për këtë proces, liria: *Po unë a të pranoj të m’i lash ti këmbët? / A nuk do më zërë mallkimi i krojeve? Vështrimi im si unazë që bie në ujë, / të ra në zemër / dhe u hutove.*

Janë dy pyetje retorike që flasin për refuzimin e këtij shërbimi që i bëhej mikut si nderim, duke poshtëruar krijesën delikate dhe të bukur, femrën. Vargu “vështrimi im si unazë që bie në ujë të ra në zemër” ndërtohet nga një krahasim: *vështrimi im si unazë që bie në ujë* dhe një metaforë: *të ra në zemër*. Parë në rrafshin estetik krahasimi është i gjetur dhe origjinal. Fjala *unazë* mbart tërë ngarkesën e semantikës estetike dhe semantikës kuptimore: vështrimi është tepër i

¹ V. Zhiti, *Hedh një kafkë te këmbët tuaja*, 1994, f. 142.

² M. Foucault, *Disiplinë dhe ndëshkim*, 2010, f. 19.

³ V. Zhiti, *Dyert e gjalla*, 1995, f. 36.

⁴ Po aty, f. 55.

Miti i femrës në letërsinë e penguar

rrallë dhe i vyer si unaza, si ari. Rënia në ujë e unazës është e butë, por disi dramatike, nga frika e humbjes. Metafora *të ra në zemër* shkakton hutimin e femrës, pra ajo e merr mesazhin dhe e pranon atë. Ajo, ndonëse me një status përbuzës ende nuk e ka humbur ndjeshmërinë, sikurse edhe bukurinë. Uni poetik revoltohet duke refuzuar nderimin (larjen e këmbëve), që njëkohësisht është çnderim. Duke e mitizuar femrën ai bën thirrje për sjellje të qytetëruar ndaj saj: *Largomani legenin - këtë verbëri të turbullt! / Çohuni në këmbë ju shkëmbin! / Që të mos mbeten në egër bëjini vend të Bukurës, / Perëndeshës së jetës!*⁵

Në këto vargje dallohet qartë mitizimi i femrës si rezultat i destruksionit të mitit të saj nga zakonet dhe kodet shqiptare. Ajo thirret Bukuri me B- të madhe dhe Perëndeshë e jetës.

Më lart folëm për vizatimin e një nudoje në burgun e Spaçit, e cila solli tronditjen e krejt kampit, edhe të të burgosurve, edhe të komandës, natyrisht në sens të ndryshëm. E kanë përmendur në kujtimet e tyre këtë fakt edhe shkrimtarë dhe artistë të tjerë të burgosur, ndërsa poeti Visar Zhiti e sjell në mënyrë artistike në tekstin e poezisë së tij me titull “Gruaja komplotiste”: *Dy sy të mëdhenj... / ...buzët, / ...supet e zhveshura të mermerta... / barku, fundi i barkut... / Lakuriq, pa turp / para nesh qendronte jeta.*⁶ / Në shtjellën e krijuar kemi dy trazime: a. Trazimi i të burgosurve, i cili ishte shpirtëror, estetik, mendor: *Një grua / doli nga muri i burgut...buzëqeshte... / Ajo u dha shpirt gurëve, / gurët nuk ishin më heshtje.* / Efekti i nudos te të burgosurit, te uni poetik është krejt njerëzor: *Buzët e saj / pakëz të hapura /na mërmëritën fjalët e dashurisë së parë. / Këmbët tona të zbathura / shpikën vezullueshëm një bulevard.*⁷

Duke qenë njerëzor, shkakton edhe zgjimin instinktit dhe kërkimit të lirisë. Në tekst përdoret grotesku për të dhënë përmasat e pështjellimit shpirtëror të të burgosurve: *Desh filluam një kryengritje / mbas pak. / Erdhën përforcime, / Se nga doli një tank.*

b. Trazimi i diktaturës, i cili ishte trazim ideologjik, instiktiv mbrojtës nga e bukura, nga arti si agresion. Poeti përdor sërish groteskun për të vizatuar pështjellimin e diktaturës: *Filluan reprezaljet. / Të gjendet piktori që organizoi komplotin kundra shtetit / Dhe kjo grua agjente që u hodh me parashutë mbi kamp / të pushkatohet.*⁸ Teksti mbyllet me dy vargje, ku nënvizohet qartë se frymëzimi artistik është frymë hyjnore, sikurse edhe shpresa për liri: *Vërtetë / nga qiejt erdhi, nga lart...*

Në tekstin e poezisë të titulluar “Zemër...”, e cila është shkruar në burgun e Qafë- Barit në vitin 1983, Visar Zhiti thotë: *Nxitojnë muzgjet, / Nxito dhe ti që të arrish më përpara se muzgjet. / Ecën në këmbë, / sepse s’lejohen takimet natën. Nxito, / që të vesh ti më parë se mbrëmja.*

⁵ Po aty, f. 65.

⁶ Po aty.

⁷ V. Zhiti, *Hedh një kafkë te këmbët tuaja*, 1994, f. 34.

⁸ V. Zhiti, *Kujtesa e ajrit*, 1993, f. 117.

Paralelizmi figurativ ku muzgjet dhe gruaja pranëvihen në lëvizjen e tyre në ngjitjen drejt maleve (në fakt muzgu nuk ulet, por ngrihet), parë në rrafshin semantik sjell figurativisht sakrificën e femrës që sfidon kohën në të mirë të burrit të saj të burgosur. Në vargjet e fundit të tekstit gjejmë dy metafora: *dita shtanget, dita ngrin*, të cilat sjellin imazhin poetik se edhe koha ndalet në respekt të altruizmit të femrës dhe synimit fisnik të saj për të takuar burrin në burg: *Dhe dita shtanget, / Ngrin. / Të lë ty të ecësh përpara, / që të të vijë nga pas*.

Në një tekst poetik, i titulluar “Mirënjohje”, i shkruar në Spaç më 6 tetor 1982, mungesa e femrës në burg është shumë më torturuese se të gjitha mungesat bashkë. Një vajzë kalon përbri burgut dhe shtang një burg të tërë. Burgu bëhet më burg: *...Të shohim, / të shohim, / por s'të ndjekim dot, / veç me sy...Na u plasaritën sytë si xhamat...Zbathur shkelim mbi xhamat e syve tanë / dhe s'të arrijmë e s'të arrijmë dot...*⁹ Metaforat befasuese si: *na u plasaritën sytë* (plus krahasimin *si xhamat*), *zbathur shkelim mbi xhamat e syve tanë, hapim mjegullat* (plus krahasimin *si perdet*), *shtyjme kullat e rojeve, shtyjme robërinë apo malet*, apo krahasimi: *gjethet bien si puthjet tona të thara në rrugë*, vizatojnë me dramacitet e tragjizëm mungesën e femrës, natyrisht e vizatojnë femrën si një qenie mitike. Teksti mbyllet me një varg ku krahasimi i peshës së prangave me peshën e gurëve të varreve flet në të mirë të argumentit se mungesa e femrës në burg është ndëshkim që i drejtohet njëkohësisht edhe trupit edhe shpirtit. Dhe ky ndëshkim i padrejtë vazhdon me dhjetëra vite, apo edhe një jetë të tërë. Prania e femrës rastësisht përbri burgut bën që: *Prangat rëndojnë më shumë se gurët e varreve*.

Visar Zhiti, pas daljes nga burgu, u dërgua të punonte si punëtor në fabrikën e tullave në qytetin e Lushnjes. Në tekstin e poezisë “Gratë e fabrikës së tullave” gjejmë këto fjalë dhe shprehje çelësa: *gra, lule, sy, rimel, peizazhet e trishta, stivosin tulla, bluzë qiejsh, enigmë, dallëndyshe, duart e dashurisë, shtyjnë njëra tjetrën si hallet, si duaj gruri, balta, unaza, poezi*. Është një tekst si vijim i tekstit të poezisë “Në kullën e gruas së bukur”. Femra, përherë një mit për poetin Visar Zhiti, punon në një fabrikë ku puna është tejet e vështirë edhe për meshkujt. Në këtë mjedis feminiteti i saj vritet çdo ditë: *Gra, të cilave / askush mund të mos u ketë dhënë lule në jetë / ... punojnë stivosin tulla nëpër rafte metalike... / ...Balta nëpër duar / e mbuloi unazën / bashkë me retë që mbuluan hënën. / U lodhën gratë, / u ulën së bashku tufë. / Si duaj gruri ngjajnë- rënë nga qerrja rrugës...*¹⁰

Balta që mbulon unazën dhe retë që mbulojnë hënën pranëvihen si dukuri që përbaltin kujdesin dhe errësojnë të bukurën. Ndërsa krahasimi *Si duaj gruri ngjajnë- rënë nga qerrja rrugës*, sjell në kujtesën tonë trajtimin jo dinjitoz të gruas. Në tekst ndërtohet edhe ëndrra e çdo femre, të vishet bukur e me dinjitet: *...të kesh një bluzë qiejsh me një papjon të zi si enigmë dallëndyshesh, / një fund bluxhins, i çarë, sikur e çanë duart e dashurisë që u çmend*.

⁹ V. Zhiti, *Hedh një kafkë te këmbët tuaja*, 1994, f. 151.

¹⁰ V. Zhiti, *Kujtesa e ajrit*, 1993, f. 107.

Miti i femrës në letërsinë e penguar

Në tekst, krahas mungesave që vijnë nga varfëria materiale, e njohur kjo në vitet e diktaturës, vihet re edhe varfëria shpirtërore e burrit: *Gra, të cilave / askush mund të mos u ketë dhënë lule në jetë, / Nëse ishte e pamundur të falje një bluzë qiejsh, një tufë me lule apo një lule gjendej kudo.* Në tekstet poetike të Visar Zhitit femra është mit, jo vetëm si rrjedhojë e mungesës së saj, por edhe si rrjedhojë e pranisë së saj: *Me vetëtimën / a mund të lësh takim? Si vetëtima je ti, si vetëtima / kaq bukur e frikshme. / Shkrepëtin dhe mbush me dritë të harbuar / hapësirën e tjetrit.*¹¹ Krahasimi si vetëtima dhe vargu *kaq bukur e frikshme* mbartin një ngarkesë të fortë semantike edhe në rrafshin estetik, edhe në rrafshin kuptimor. Vetëtima bën dritë, shfaqet befas, shfaqet e rrezikshme, të godet krejt si bukuria (edhe ajo bën dritë, të godet, është e rrezikshme). Vargu *kaq frikshëm e bukur* me mjete mjaft të kursyera vizaton bukurinë e femrës. Dihet, kur një fenomen, një dukuri, në këtë rast bukuria e femrës, shfaqet në përmasa të mëdha dhe me një intensitet të pazakontë, të frikëson. Në tekstet poetike të Visar Zhitit femra vizatohet me të gjitha huret e saj fizike dhe shpirtërore, herë- herë me natyralizëm, shpesh të estetizuara deri në mit. Visar Zhiti mungesën e femrës e shikon si mungesë të gjysmës së domosdoshme të burrit, pa të cilën ai është i papërsosur, i pamjaftueshëm, i frustuar. Prania e saj e bën burrin më të bukur, më njerëzor, më të mirë. Uni poetik gjen te femra gjerat e vogla që na mbushin jetën e përditshme, por edhe gjerat e mëdha, me të cilat burri merr dimensionin e botës. Në tekstin e poezisë “Nga kokrra e qershisë deri te universi” thuhet: *Si një fryt gjithë lëng / gati të bjerë nga dega, / Ti mbushur tërë dashuri je / ja ashtu si buzët e tua gjysmë të hapura, / si gjinjtë rënkimtarë / si trupi yt i kaltër / që valvitet nëpër dallgë ere, / rrotullohet, rrotullohet / dhe ajri nxjerr shkëndija nga fërkimi me Ty.*¹²

Vargu i fundit na shtie në mendje se Visar Zhiti beson te e bukura verbërisht, me sigurinë se e bukura është gjithmonë e vërtetë, ndonëse e vërteta nuk është gjithmonë e bukur. Bukuria jepet jo e ngrirë, por në lëvizje, në veprim duke jonizuar edhe objektet me shpirt edhe ato pa shpirt si ajri.

Mitizimi i femrës kap kuota të larta në vargjet e mëposhtme, po tek i njëjti tekst: *Ti çahesh për të më futur mua. / Që të më shpëtosh nga humnerat e hiçit.*

Ndërsa dy vargjet në vijim, uni poetik përsosjen e tij edhe fizike edhe shpirtërore e shikon si rrjedhojë e daltës së dashurisë, daltë e cila u përdor mjeshtërisht nga duar gruaje: *M'i hoqe gjithë pjesët e tepërta dhe le / Fytyrën e njeriut tek unë.*

Poezia e Visar Zhitit është “thurur” me fije humanizmi sikurse shkruan tek teksti i poezisë me titull “Trokitje patjetër”: *E jeta që s'mjafton për dashurinë... e tmerrshme të gjesh kohë / për urrejtjen.*¹³

Në tekstet poetikë të Frederik Rreshpjes, portreti i fizik i femrës përgjithësisht është i papërcaktuar. Në këto tekste femra është e pranishme me mungesën e saj, gjë që shkakton përftime estetike edhe më të forta se sa prania. E bukura si frymë

¹¹ V. Zhiti, *Kujtesa e ajrit*, 1993, f. 107.

¹² Po aty.

¹³ Po aty.

organizon tekstin poetik nën magjinë estetike të saj. Nëse te tekstet poetike të Visar Zhitit femra vizatohet si prani edhe fizike, shpirtërore dhe estetike, në tekstet e Frederik Rreshpjes ajo vizatohet si mungesë fizike, por si prani shpirtërore dhe estetike (“*E mira ime prej lotësh*”- titullohet një tekst poetik i tij). Në tekstet poetike të Frederik Rreshpjes përgjithësisht mungon imazhi, por është i pranishëm rrezatimi dhe efekti: *Qan era në kallamishte me dhembje, / Trishtohet për fëmijët e vet. / Hën’ e artë mesdhetare / Si zemra ime rri varur mbi drurët. / Gjethe të verdha rrëzohen nga retë e vjeshtës. / Dikush po ikën / Por tërë këto shira / Jo, nuk bien për një ndarje të thjeshtë.*¹⁴

Nëse te tekstet poetike të Visar Zhitit prania e femrës me kurmin e saj, me shpirtin e saj e përsos unin poetik, e çliron nga gjërat e tepërta duke i lënë fytyrën e njeriut¹⁵, te tekstet Frederik Rreshpjes mungesa e fizikut të femrës, mosprania e hireve të kurmit shkakton te uni poetik dhembje, por edhe dhembja e përsos njeriun, pra në forma të ndryshme, arrijmë të njëjtin efekt. Në tekstin e poezisë “Fund vere” shohim se mungesa e asaj pikëllon unin poetik, por edhe i gjithë peizazhi ngjyrosset me dhembje: *Vera që shkoi i pikëlloi qiejt / Siç pikëllohem unë për ty. / Mbi plazhet e shkreta, tërë dhembje / ulërijnë rrufetë me kujë.*¹⁶

Në tekstet e Frederik Rreshpjes duket sikur uni poetik vrapon në skaj të dhembjes, sikur e ndjek, e kërkon atë. Në tekstin e një poezie të titulluar “Mos e mallko me ndarje këtë natë” ndeshim një varg tronditës: *Dashuria ime mund të bëhej çati e tërë botës. / Ky varg flet shumë për energjinë e jashtëzakonshme që gjeneron shpirti i unit poetik, por dëshpërimisht në tekstet e poezive, subjekti poetik endet nën shi, pa dashuri, pa çati: ...U shuan yjet në pëllëmbët e mija / Dhe sytë e tu u bënë dimër. / E kam ditur ç’braktisje më pret / Moti ky zog ma ka thënë. / ose: ...Rri kyçur në gur zemra ime / Një mijë vjet dhe dy mijë vjet.*¹⁷

Në tekstin e poezisë “Rri e rri” ndeshim një dukuri që qartëson mendimin tonë se dashuria si energji ekziston te uni poetik, pavarësisht mungesës së femrës. Mjedisi shpirtëror i kësaj dashurie, me të gjithë arkitekturën e tij është i përhershëm, në pritje të ardhjes së asaj. Kur ajo nuk vjen, *drurët e pritjes bëhen dimër dhe bora çel lule te era.*

Në fund të tekstit kemi tre vargje që shpjegojnë qartë se dashuria e unit poetik jo vetëm që është parake, krahasuar me femrën, por orvatet pa reshtur që të sjellë këtë të fundit për të vënë rregull në mjedisin shpirtëror të dashurisë së tij. Në këtë tekst kemi tre kohë, ku druri i pritjes çel gjethe, pastaj vishet me vjeshtë dhe në fund bëhet dimër. Në fund, ndonëse dashuria e tij u mundua shumë për ta sjellë, ajo nuk erdhi dhe unit poetik i duhet të shohë vetëm yllin e mbrëmjes: *Më kujton sytë e saj. Sidoqoftë, dashuria e unit poetik nuk thyhet: Vetë tani që u sosën stinët.*

¹⁴ F. Rreshpja, *Erdhi ora të vdes përsëri*, poezi.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ F. Rreshpja, *Në vetmi*, 2004-123.

¹⁷ Po aty, f. 12.

Miti i femrës në letërsinë e penguar

/ E kam kuptuar që dashuria ime s'të sjell në këtë botë; / Megjithatë, çdo ditë ngre ura e rrugë.¹⁸

Në këtë tekst miti i femrës kryqëzohet me mitin e metamorfozës. Në dallim nga tekstet e tjerë këtu ka një dritëz shprese për ardhjen e saj. Uni poetik, ndonëse ajo nuk erdhi, *çdo ditë ngre ura e rrugë*. Bie në sy përgjithësisht në tekstet poetikë të Frederik Rreshpjes përdorimi i foljes *ike* dhe mungesa e foljes *erdhe*. Edhe në një rast të përdorimit të foljes *erdhe*, menjëherë pas saj përdoret emri *ikje*: *Pastaj erdhe ti tërë ikje*.¹⁹

Në të gjithë tekstet poetikë fjalët çelësa janë shiu, vjeshta, dimri, ndarja, pikëllimi, dhembja, hëna. Ikja, ndarja, pritja janë shenja në tekstet poetike të dashurisë të Frederik Rreshpjes. Ndoshta për të shpjeguar tekstin lipset për të hedhur një vështrim mbi jetën e autorit, e cila ka qenë vërtetë e dhimbshme: *Kështu çdo natë të pres ty, si skllav; Rri e vështroj yjet si ngrajnë statuja / Mbi pirgjet e kështjellave që vizatojnë errësirën... Kështu çdo natë vjen vërdallë nëpër kopsht një hije, / Me një qiri prej hëne në dorë...*²⁰

Në tekstin e poezisë “Druri i portës” vërejmë se uni poetik është kthyer në një torsë pritjeje të dashurisë. Nga pritja druri i vdekur i portës çeli lule, edhe uni poetik çeli gjethe si palmat, por këto lule, nga pritja e gjatë, vlejnë vetëm si kurora mortore: *Lulëzoi druri i portës së vjetër. / Ah, druri i vdekur çeli lule! / Ti këputi dhe me to bej kurorë, / Për mua që të prita*

*deri në vdekje. / ... Të prita, të prita... / Derisa çelën kameliët e mortjes te porta. / Ti mblidhi dhe më bëj një kurorë, / Mua që deri në vdekje të prita.*²¹

Diskursi erotik i Frederik Rreshpjes është në tërësinë e tij rrjedhë e sprapsme e humbjes. Të gjithë tekstet kanë si rifiniturë trishtimin, pikëllimin, vetminë si pasojë e humbjes së dashurisë. Nuk mungon edhe shpresa për rikthim si në tekstin e poezisë “Aerodrom”: *Dal e të pres në breg të një qielli, / Dal e të pres buzë një reje. / Vështroj si rrëzohen shirat, ylberët, yjet.*²²

Siç shihet në këtë tekst edhe vendi i pritjes nuk është në tokë, por lart në qiell, a në breg të një qielli, nuk është në një port, por buzë një reje. Më tepër se dashurinë reale, uni poetik kërkon e pret dashurinë sublime platonike. E pret të ulet poshtë me shirat, ylberët, yjet. Madje është aq i sigurtë se ajo gjendet aty, sa guxon edhe e urdhëron: *Zbrit! / E di që je diku pas një mjegulle.*²³

Si në të gjithë tekstet me diskurs erotik të F. Rreshpjes, ai nuk takon dashurinë, por humbjen e saj. Në pritje që dashuria e tij të zbresë poshtë, dhimbja e tij ngrihet lart: *Venë e vinë avionët e botës. / Po ti. në ç'shira je fshehur vallë? / A e ke parë dhëmbjen time / Si ngjitej me ulërimë nëpër qiej?*²⁴

¹⁸ Po aty, f. 27.

¹⁹ Po aty, f. 11.

²⁰ Po aty, f. 21.

²¹ Po aty, f. 20.

²² Po aty.

²³ Po aty.

²⁴ Po aty, f. 25.

E në vijim autori është humbësi më i madh, ndërsa lexuesi është përfituesi më i madh estetik nga vargje të tillë. Për këtë është i vetëdijshëm edhe autori. Në një tekst tjetër poetik të Frederik Rreshpjes me titull “Peizazh pa ty” ndeshim këto vargje: *Dikush po ikën / Por tërë këto shira / Jo, nuk bien për një ndarje të thjeshtë*.²⁵

Ndarja është e madhe, është ndarja me njeriun e dashur. Në tekst sërish ndeshim një pyetje retorike, që më shumë se pyet shpjegon: *O palma, / Për kë festojnë këto portokalle? / Unit poetik i duket bosh peizazhi pa të dashurën*. Madje ai çuditet kur shikon se në peizazhin pa të dashurën e tij ka ende dritë: *Dhe dritat e portokalleve i lëkund era në muzg / Mbi detin tërë valë*.²⁶

Në tekstet poetikë të Frederik Rreshpjes miti i humbjes së përhershme shoqërohet edhe nga miti i metamorfozës, kur trishtimi, dhimbja, pikëllimi janë të përmasave të mëdha. Në këtë rast miti i metamorfozës është rrjedhojë e mitit të humbjes. Boshi që lë pas humbja e dashurisë e kthen njeriun, në këtë rast unin poetik, në shpirt të shkretëtirës dhe koha do të kthehet në rërë.

Miti i femrës në poezinë e Frederik Rreshpjes, sikurse kemi nënvizuar edhe më lart, është miti i së bukurës përherë si prani, ndonëse femra, objekti që e rrezaton këtë bukuri nuk është i pranishëm në kohën e ligjërit. Femra është mit në poezinë e tij, sepse me mungesën e saj ngjyros dhe ç’ngjyros peizazhe, ndërrojnë stinët, mbulon me borë fushën dhe pemët, hënën e kthen në qiri, borën e kthen në qefin, formon kryqe shiu, drurin e portë e bën të çelë lule, sytë i ruan në kujtesën e ujërave, rrëzon nga kashta e kumtrit tërëfilin e artë të qiejve, druri i pritjes bëhet dimër, dëbora çel lule te era.

Në tekstet lirike të Mihal Hanxharit shndërrimet ndodhin në të dy kahet. Në ndryshim nga tekstet poetikë të Frederik Rreshpjes, ku erotizmi është thjesht dukuri estetike, dhembje e bukur, i përcaktuar, i largët, mungesor, te tekstet poetike të Mihal Hanxharit erotizmi është i prekshëm, i afërt, i realizuar, burim prehje, burim vërtetësie dhe paqeje shpirtërore. Shndërrimet si rrjedhojë e dashurisë në tekstet e Mihal Hanxharit janë alternative, të dy krahët shndërrohen nga energjia erotike që i përcjellin njeri-tjetrit: *Unë isha lumë ti ishe lumë / Unë isha det ti ishe det / Det nëpër det humbur në gjumë / O trupat tanë o ato net*.²⁷

Në tekstet erotike të Frederik Rreshpjes metamorfoza ndodh tek uni poetik, në objektet rreth unit poetik dhe portretit të paqartë të femrës. Ndërsa te tekstet erotike të Mihal Hanxharit metamorfoza përfshin së pari unin poetik dhe femrën dhe pastaj edhe mjedisin rreth tyre: *O fushë o pemë e trupit tënd / Lule shege e buzës sate / Buzët i vura në çdo vend / në trupin tënd plot diej nate*.²⁸ Në tekstet erotike të poetit Frederik Rreshpja erotizmi shprehet me drejtimin e lëvizjes nga toka drejt qiellit, ndërsa te Mihal Hanxhari ndodh e kundërta, erotizmi është tokësor, natyrisht jo pa magjinë kozmogonike, ku diej dhe yje ulen e ndizen aty në

²⁵ Po aty.

²⁶ M. Hanxhari, *Gdhend një statujë*, 2005, f. 80.

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty.

tokë: *Më more flokët nëpër duar / Më more gjirin përmbi gji / O si u ndezën yjet e shuar / Yjet e shpirtit përsëri*²⁹. Në një mjedis shterp shpirtëror, ku terrori, intriga, përgjimi janë praktika të zakonshme të sistemit totalitar, shpëtimi për unin poetik është dashuria. Për unin poetik në tekstin e titulluar “E vogla ime”³⁰ dashuria shndërrohet në gur nën ijë, pluhur të udhës, dorë në muzg të ditës, në valë e qetë e lodhjes, në det të vakët të dëshirës, në breg të qetë të besimit, në skelë të vetme të natës. Siç shihet të gjitha shndërrimet janë në funksion të prehjes, gjetjes së qetësisë, gjetjes së besimit: *E vogla ime / Valë e qet’ e lodhjes sime / Det i vakët i dëshirës / Breg i qetë i besimit / E vogla ime*.³¹

Në tekstet erotike të poetit, krahas *dashurisë* gjen edhe *vdekjen*, si ndarje. Madje pothuajse në të gjitha tekstet erotike ndarja shihet si pasojë që e shkakton vetëm vdekja. Nuk ka shkaqe të tjera të ndarjes, veç vdekjes, e cila është fenomen suprem. Vargjet: *si do të vdes pa ty, si do të le, dhe qëndroj qëndroj dhe s’vdes se jeton ti*, tregojnë për një dashuri të fortë dhe të qëndrueshme në poezinë erotike të Mihal Hanxharit. Në tekstin e poezisë “Ti ankora ime” dashuria dhe metamorfoza si rrjedhojë e forcës së saj sublime përfshin, sikurse e nënvizuam më lart, të dy krahët. Te poezia erotike e poetit shndërrimet nuk janë traumatike, të dhunshme, por të buta, elegante si rrjedhojë logjike e afrimit, përsosjes dhe bashkimit shpirtëror të protagonistëve. Sublimitetin e një takimi, dimensionin qiellor të dashurisë e takojmë në dy vargjet e parë të këtij teksti: *Atë natë në ajrin e vakët / Sikur qemë zhytur lakuriq në qiell*.³² Uni poetik ndihet i realizuar pikërisht në dashuri, pas lë dëshpërimit dhe vuajtjes: *Ah ku ta dinte dëshpërimi që ne e kishim lënë tashti / Ku ta dinte që ne e kishim tradhëtuar vuajtjen*³³. Metamorfoza përfshin të dy kahet; të dy shndërrohen në paqe, luftë, fitore e humbje, lumë shtrat lumi, shi e qiell, zog e pyll, çezmë si shpatë drite, ndërsa gjiri i saj shndërrohej në *kopsht ditën e vjeljes: I dhamë përsëri njeri tjetrit rrugicat e trupave tanë / Të dy qemë paqja dhe lufta fitorja dhe humbja / Të dy qemë lumi dhe shtrati qielli dhe shiu zogu dhe pylli*³⁴. Në tekstet e “Letërsisë së penguar” kemi vënë re se uni poetik në përpjekje për të gjetur prehjen, lirinë, kuptimin e jetës, për të shpëtuar nga përgjimi, dhuna, intriga ka synuar ikjen. Disa patën fatin të kalonin kufirin, disa përfunduan në burg, disa në kampe përqendrimi. Uni poetik te tekstet e Mihal Hanxharit arratiset me sukses në dashuri ku ndihet i lirë, ndihet siç thotë në një poezi të tij “i mjeri më i lumtur” apo “Jetoj vetëm se dashuroj si i pavdekshëm”.

Poema lirike “Menhir” e këtij poeti, për mendimin tonë, është një nga krijimet më të arrira në llojin e saj. Parë në rrafshin estetik dhe në rrafshin semantik te kjo poemë i gjejmë të gjithë arketipet e diskursit poetik të Mihal Hanxharit si dashuria si zanafillë dhe njëkohësisht si përjetësi e ekzistencës së njeriut, dashuria si

²⁹ Po aty, f. 208.

³⁰ Po aty, f. 221.

³¹ Po aty.

³² F. Rreshpja, *Në vetmi*, 2004, f. 27.

³³ M. Hanxhari, *Gdhend një statujë*, 2005, f. 221.

³⁴ M. Hanxhari, *Gdhend një statujë*, 2005, f. 255.

perandori e përjetshme, dashuria si kontinuitet i pandërprerë etj. Menhir emërtohet një gur i gjatë, i ngulur në tokë si monument i kohës prehistorike. Menhirët dhe dolmenët janë monumente megalitike që gjenden me shumicë në Francën veriore dhe në Itali. Poema në fillësën e saj ka edhe pyetje të tilla: *Ku është ajo faqe shkëmbi në cilën shpellë / Ku janë afresket e duarve tona të lashta*. Në tekst, shohim se njeriu është po ai: duart e tij kanë pikturuar shpellat në mug të qytetërimit. Kujtesa e shekujve që bie pike - pikë formon kujtesën shekullore në formë stalakmiti: *Në çdo pikë që bie në kumbim vetmie*. E tillë është edhe dashuria që vjen nga thellësia e shekujve duke lënë pas monumente si menhired dhe dollmenet që janë dashuria e shndërruar në kujtesën prej guri: *Në çdo vis të largët shtrirë në gjakun e përndimeve memce / Ngrihen dollmenët e menhired e fushave të menduara / Klithma të ngrira puthje motesh që s'mbyllën sy kurrë / Lëshim kunis fill era që do të shkojë te buzët e yjeve /*. Dashuria për unin poetik të poemës nuk ka prehje, nuk ka gjumë. Ajo vjen nga thellësia e shekujve pa mbyllur sytë, pa heshtur: *Myshqe që mbinë aty ku buzët puthën jetën / Kujtim i mbetur dëshmi dashurie / Dritare pa xhame gji i çarë i kujtesës*. Në këtë tekst poeti i këndon dashurisë jo vetëm në planin personal, por në përmasat e dashurisë si perandori e përjetshme dhe njeriut si kontinuitet i njerëzimit. Energjia e dashurisë është pasqyrtshme si drita, e përjetshme si drita dhe e paasgjësueshme si drita. Në tekst dashuria është ngjitje: *Kur u ngjitëm të dy për herë të parë mbi kodër / Kur e ndjemë që deti ish atje përtej /*, dashuria është edhe përmasë: *Kur nga larg valët e detit lëshonin mandilet drejt nesh / Nëpër nebulozën blu si në ditën e parë të botës*, dashuria është lartësim në përmasa kozmike, komunikim qiellor: *Pamë gjirin e qiellit në një pasqyrë erërash të kripura / Ndjemë mërmërimën e ardhur nga gëzimi i parë / Shira dritash pluhur dielli lajmërim i nisur drejt nesh*.³⁵

Poeti Mihal Hanxhari e sheh dashurinë të vjetër sa bota, dhe të dashuruarit të vjetër sa dashuria. Në rrafshin semantik ky përcaktim është i përligjur. Te njeriu ekziston e djeshmja, e sotmja dhe e nesërmja në formë kujtese, gjuhe, genesh, eksperience, tiparesh. Edhe dashuria e sotme shndërrohet dhe krijonë menhired e së nesërme: *Dhe aty buzë detit lëshuam hijen tonë / Hije menhiresh dashurie që përqafohen përjetë me kujtimin*.³⁶

Sërish në tekst nënvizohet se çdo kohë ka monumentet e vet të dashurisë. Prehistoria na dërgon një kumt për dashurinë e përjetshme nëpërmjet menhireve dhe dollmenëve, ndërsa dashuria e sotme i projektton menhired dhe dollmenet si kumt e dëshmi për brezat që do të vijnë. Teksti është thurur me fjalë që shënojnë elemente zanafillorë si: menhir, dollomen, qiell, yje, myshqe, det, shkëmb, gurë shpellë, kohë, erë, vale, rërë, diell dritë, elemente materiale të përjetësisë. Po ashtu përdoren edhe fjalë që shënojnë elemente të përjetësisë shpirtërore si: shpirt, afresket e duarve, kujtimi, kujtesa, koha, shpirta pengje, ëndrra uji, psalme, fjalë të verdha dielli, hije mehiresh dashurie etj. Uni poetik i drejtohet elementëve të përjetësisë: *O rërë / Me një diell brenda çdo kokërrize / Me një stinë brenda çdo*

³⁵ Po aty.

³⁶ Po aty.

*thërrmije / Ti rërë muzikë e fshehur që kumbon brenda çdo grimce / Rërë me pikëllimin e çdo ylli në gjirin tënd / Me pasqyrën e thërmuar të hënës në më të vjetrin mot / Rërë na mbajte në pëqirin tend.*³⁷ Në këtë fragment të tekstit të poemës gjejmë edhe vargje që mbartin te vetja tharmin e rrafshit estetik dhe tharmin e rrafshit semantik të poemës: *Rërë mërmërimë zëri antik që flet me vete... O ti rërë arkiv i botës i dritës i natës / Ti që ke ruajtur të gjitha dashuritë në një fosil syhapur.* Aliteracioni që përdoret në pjesën e parë të vargut “*Rërë mërmërimë zëri antik që flet me vete*”, të krijoj në vesh muzikalitetin e hapave që vijnë nga thellësia e kohërave, hapave të lashtë sa rëra. Po cili është fosili syhapur i dashurive të ruajtura nga rëra? Ja si thuhet në tekst: *Hark krahësh në qiell / Udhë e rratur e pulëbardhës që vej e vij mbi kryet tanë / Klithmë hareje në blunë e verës / Kumbim kambane kobalti në kupolën e gëzimit*³⁸. Pas thirrjes së rërës, si element zanafillor, në tekst kemi thirrjen detit, një tjetër elementi përjetësie: *O det që i di të gjitha që i ke parë të gjitha / Skribë i qetë e i duruar / Aed që nis e i këndon varg pas vargu.*

Përjetësia e detit shihet në planin e përjetësisë së dashurisë, si simbol i saj. Deti mban te vetja fantazmat e anijeve të mbytura, deti që ka të pasqyruara te vetja të gjitha historitë e dashurive të hënës, deti që tregon historinë e çdo ylli nëpër natë, ndriçimin apo shuarjen e tyre, metamorfozën e tyre nga yje në peshq (pasqyrimi në det): *Dashuritë e pamatshme të zjarreve yjorë / Përqaftimet pushtimet e dashurive qiellore / E ato kaskada yjesh të rinj / Miliona peshq argjendi në akuarin e zi.* Më tej në tekst apostrofa i drejtohet një tjetër elementi përleshmërie, reve, të cilat janë metamorfoza e shpirtit të tokës, e dëshirave, ëndrrave, psherëtimave të saj: *O histori e reve pot ethe të tokës që digjet / Psherëtimat të tokës dëshira ëndrra që planojnë sipër dheut / Re re forma pafund arkitektura fliudetë papërsëritshme / Re shpirt i tokës që shkon në hapësirë/ ... Rërë det e re / Menhirin e dashurisë ah e keni ju.*³⁹

Pasi apostrofon të dashurën, rërën, detin, retë, uni poetik në tekstin e poemës “Menhir”, i drejtohet dashurisë: *Sepse dashuria s’është njeriu që duam / Por ajo lumturi plot dëshpërim që kemi ndjerë.* / Këtë koncept për dashurinë, ku ajo nuk identifikohet me njeriun që duam, por me lumturinë plot dëshpërim që kemi ndjerë, më parë e kemi ndeshur në poezinë e Lasgush Poradecit: “*Se s’dashuroja as un’ as ti / Po dashuronte dashuria.*” Mund të jetë ndikim nga poeti i shquar, por mund të jetë ndikim i drejtpërdrejtë nga simbolistët frëngë, të cilët Mihal Hanxhari i ka sjellë në gjuhën shqipe. Dashuria në këtë tekst shihet si streha e fundit, më e sigurt, por edhe natyrisht më e vetmuara: *Dhe një ditë shohim se jemi vetëm / Të lënë të braktisur / Për t’u mbytur te ti / Dashuri.*

Poeti Mihal Hanxhari e shikon dashurinë si energjinë e vetme pozitive që i jep kuptimin jetës dhe si arsye thelbësore pse ia vlen të jetosh: *O dashuri lot i vesës në qepallë të mëngjesit / Dashuri dashuri dritë e butë e muzgut plot gjemi / Muzika jonë pa kujtesë.*⁴⁰

³⁷ M. Hanxhari, *Gdhend një statujë*, 2005, f. 255.

³⁸ Po aty.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Po aty.

